

## Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti ekonomik i UP
Titulli i lëndës:	Kontabiliteti i menaxhmentit
Niveli:	BA
Statusi lëndës:	Obligative / zgjedhore
Viti i studimeve:	2
Numri i orëve në javë:	2+1
Vlera në kredi - ECTS:	6
Koha / lokacioni:	Semestri i tretë
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof.asoc.dr. Skender Ahmeti Prof.asoc.dr. Rrustem Asllanaj
Detajet kontaktuese:	E-mail: <a href="mailto:skender.ahmeti@uni-pr.edu">skender.ahmeti@uni-pr.edu</a> <a href="mailto:rrustem.asllanaj@uni-pr.edu">rrustem.asllanaj@uni-pr.edu</a>
<b>Përshkrimi i lëndës</b>	Kontabiliteti i menaxhmentit është lënda e dytë në listën e lëndëve që ofrohen nga fusha e kontabilitetit që i dedikohet shfrytëzuesve të brendshëm të kompanisë. Kjo lëndë është për studentët e studimeve bachelor - viti i dytë.. Lënda është e orientuar në njohjen tuaj me raportet e brendshme më të avancuara që i përgatit kontabiliteti për nevoja të menaxhmentit.
<b>Qëllimet e lëndës</b>	Kontabiliteti i menaxhmentit është i dedikuar për përgatitjen e informatave të nevojshme për menaxhmentin. Qëllimi i lëndës konsiston në njohjen e veglave të kontabilitetit të menaxhmentit që përdoren në raste të ndryshme të vendim marrjes. Ekzistenca e kontabilitetit të menaxhmentit është domethënëse për shkak të rolit të tij në marrjen e vendimeve afariste dhe zgjidhjen e shumë paqartësive afariste. Gjithsesi kuptimi themelor i kontabilitetit është ndihma në marrjen e vendimeve por në rastin e kontabilitetit të menaxhmentit theksi është në marrjen e vendimeve për shfrytëzues të brendshëm. Materialet janë të aplikueshme jo vetëm për biznesin por edhe për situata tjera që kanë të bëjnë me shfrytëzimin e informatave të efikasitetit dhe efektivitetit.
<b>Rezultatet e pritura të nxënies</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të kuptoni menaxhimin dhe klasifikimin e kostove,</li> <li>• Të kuptoni procesin e kalkulimit të kostos për forma të ndryshme të prodhimit dhe të përcaktoni pragun e rrezikut,</li> <li>• Të përcaktoni performancën e biznesit përmes sistemit të përlogaritjes variabile,</li> <li>• Të kuptoni kostot relevante dhe procesin e marrjes së vendimeve në afat të shkurtër,</li> <li>• Të përcaktoni koston standarde dhe shmangiet nga këto kosto,</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>Të përpiloni dhe analizoni pasqyrën e rrjedhjes së parasë dhe efektet e këtyre analizave në performancën e biznesit.</li> </ul>														
<b>Kontributi në ngarkesën e studentit</b>															
<b>Aktiviteti</b>	<b>Orë</b>	<b>Ditë/javë</b>	<b>Gjithsej</b>												
Ligjërata	2	15	30												
Ushtrime	1	15	15												
Punë praktike	0	0	0												
Kontaktet me mësimdhënësin/ konsultimet	2	15	30												
Ushtrime në teren															
Kollokviume	2	3	6												
Koha e studimit vetanak të studentit	2	15	30												
Përgaditja përfundimtare për provim	3	6	18												
Koha e kaluar në vlerësim (teste, kuiz, provim final)	4	4	16												
<b>Totali</b>			<b>145</b>												
<b>Metodologjia e mësimdhënies</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Përcjellja e rregullt e ligjëratave dhe ushtrimeve është esenciale. Studentët të cilët janë të rregullt kanë sukses ndër- sa ata të cilët nuk shkojnë rregullisht në orë kanë probleme.</li> <li>Leximi i rregullt i kapitujve të përcaktuar më parë. Mësimi i kontabilitetit të menaxhmentit është i vazhdueshëm, kuptimi i koncepteve të reja është ngushtë i lidhur me mësimin e koncepteve nga kapitujt paraprak.</li> <li>Mundohuni të zhvilloni kuptimin e koncepteve. Mos tentoni të mbani në mend materialet. Mbajtja mend nuk do të ndihmojë në studimin tuaj.</li> <li>Në kontabilitetin e menaxhmentit, detyrat në të shumtën e rasteve kërkojnë të aplikoni konceptet e mbuluara më herët dhe të mendoni për materialet e prezentuara më herët. Këto detyra nuk mund të kryhen pa i trajtuar në esencë problemet dhe pa menduar mirë. Kjo na jep të kuptojmë se nuk duhet të ngutemi në fillimin e kryerjes së detyrës në formën teknike për detyra të caktuara.</li> <li>Duhet të kaloni pak kohë duke konsideruar mësimet e mbuluara në klasë dhe kërkesat lidhur me detyrat specifike.</li> </ul>														
<b>Metodat e vlerësimit</b>	<p><b>Shkallët e notave:</b> Ne do të shfrytëzojmë këtë shkallë të notimit për studentët e rregullt</p> <table border="1"> <tr> <td>91-100%</td> <td>- nota 10 (dhjetë)</td> </tr> <tr> <td>81-90%</td> <td>- nota 9 (nëntë)</td> </tr> <tr> <td>71-80%</td> <td>- nota 8 (tetë)</td> </tr> <tr> <td>61-70%</td> <td>- nota 7 (shtatë)</td> </tr> <tr> <td>51-60%</td> <td>- nota 6 (gjashtë)</td> </tr> <tr> <td>50-me pak</td> <td>- nota 5 (pesë)</td> </tr> </table>			91-100%	- nota 10 (dhjetë)	81-90%	- nota 9 (nëntë)	71-80%	- nota 8 (tetë)	61-70%	- nota 7 (shtatë)	51-60%	- nota 6 (gjashtë)	50-me pak	- nota 5 (pesë)
91-100%	- nota 10 (dhjetë)														
81-90%	- nota 9 (nëntë)														
71-80%	- nota 8 (tetë)														
61-70%	- nota 7 (shtatë)														
51-60%	- nota 6 (gjashtë)														
50-me pak	- nota 5 (pesë)														
<b>Literatura</b>															

<b>Literatura bazë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Prof.asoc.dr. Skender Ahmeti: “Kontabiliteti i menaxhmentit” Prishtinë, 2013.</li> <li>2. Prof.asoc.dr. Skender Ahmeti: “Kontabiliteti i kostos” Prishtinë, 2015.</li> </ol>
<b>Literatura shitesë:</b>	<ol style="list-style-type: none"> <li>1. Garrison, Noreen, Brewer: “Management accounting” McGraw – Hill, New York, 2010,</li> <li>2. Wild &amp; Shaw: “Managerial accounting”, 2010 Edition, McGraw – Hill/Irwin, New York,</li> <li>3. Hansen&amp;Mowen: “Menaxhimi i kostos: Kontabilitet dhe kontroll” – botim i përkthyer, 2009</li> </ol>

### Plani i dizajnuar i mësimit

<b>Java</b>	<b>Ligjërata që do të zhvillohet</b>
<i>Java e I-rë:</i>	Përshkrimi (prezantimi) i lëndës
<i>Java e II-të:</i>	Kontabiliteti i menaxhmentit dhe mjedisi biznesor
<i>Java e III-të:</i>	Koncepti i kostove bazike të menaxhmentit
<i>Java e IV-rt:</i>	Sjellja e kostove dhe llogaritja e kostove të përziera
<i>Java e V-të:</i>	Analiza e pragut të rrezikut apo analiza e CVP-së
<i>Java e VI-të:</i>	Disa aplikime të konceptit të CVP-së
<i>Java e VII-të:</i>	Testi i parë
<i>Java e VIII-të:</i>	Përlllogaritja variabile dhe raportimi i performancës
<i>Java e IX-të:</i>	Aplikimi i përlllogaritja variabile
<i>Java e X-të:</i>	Vendimarrja dhe kostot relevante
<i>Java e XI-të:</i>	Vendimarrja dhe kostot relevante
<i>Java e XII-të:</i>	Kostot standarde dhe matja e performancës operative
<i>Java e XIII-të:</i>	Pasqyra e rrjedhjes së parasë
<i>Java e XIV-të:</i>	Pasqyra e rrjedhjes së parasë
<i>Java e XV-të:</i>	Testi i dytë

### Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

- **Kopjimi dhe transmetimi i fjalëve nuk lejohet në këtë lëndë.** Nëse studentët takohen në këto aktivitete, ata do të trajtohen në bazë të rregulloreve përkatëse të Universitetit të Prishtinës. Me këtë rast do të merr notën e dobët dhe ky aktivitet do të përcillet në shënimet personale të studentit.